

**RENDI I DITËS**

**Shorti “Për caktimin e relatorit të kërkesave me nr. 32, 33 dhe 34 të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për vendosje sanksioni administrativ”**

**PJESËMARRJA :**

- **Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, znj. I. Osmanaj.**

**Z. Y. Merkaj:** Përshëndetje të gjithëve! Sot në datën 20.10.2023, ora 11:10 zhvillohet seanca e shortit për caktimin e relatorit për kërkesat e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për vendosje sanksioni administrativ”, me nr. 32, 33 dhe 34. Procedura për caktimin e relatorit behet me short dhe është përcaktuar në nenin 14 të rregullores së KAS-it. Për këtë kemi përgatitur 5 shirita letre, ku në tre janë shënuar kërkesat e Komisionerit me nr. 32, 33 dhe 34. dy shiritat e tjerë janë të bardhë e pa shënime. Të pestë shiritat futen në pesë gogla me peshë, ngjyrë dhe formë të njejtë në një enë transparente. Anëtarët e KAS-it duke mos qenë prezent, kanë dhënë pëlqimin dhe miratimin që të tërhiqen goglat në emër dhe për llogari të tyre, duke filluar nga rendi alfabetik rritës. Fillojmë me zotin Elvin Lako, Elvis Çefa, Ilirjan Rusmali, Koli Bele dhe në fund zoti Ledio Braho. Pesë goglat janë në një enë transparente. Pasi përziejehen nga përfaqësuesja e KQZ-së, tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të:

**Zotit Elvin Lako:** – Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të:

**Zotit Elvis Çefa:** – Kërkesa nr. 33.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të:

**Zotit Ilirjan Rusmali:** – Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.20.10.2023*

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të:

**Zotit Koli Bele:** – Kërkesa nr. 32.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të:

**Zotit Ledio Braho:** – Kërkesa nr. 34.

Në përfundim të procedurës së shortit, janë caktuar relatorët për kërkesat e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për vendosje të sanksionit administrativ”. Për kërkesën nr. 32 është zoti Koli Bele relator. Për kërkesën nr. 33 është zoti Elvis Çefa dhe për kërkesën nr. 34, relator është zoti Ledio Braho. Me kaq përfundon dhe procedura për caktimin e relatorit, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

